
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	---	--

Datë/a:	08.06.2018
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: N.N.SH. "CO-ING"
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 05.06.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.N.SH. "CO-ING", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugëve Evlija Çelebi, Luan Qelaj dhe Halil Alidemaj", me Nr. të Prok: 616 18 56 521 nxjerr:

## V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik N.N.SH. "CO-ING", të dt. 05.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve Evlija Çelebi, Luan Qelaj dhe Halil Alidemaj", me Nr. të Prok: 616 17 148 211 , kundër Njoftimit për anulim të aktivitetit te AK -së, të datës 22.03.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve Evlija Çelebi, Luan Qelaj dhe Halil Alidemaj", me Nr. 616-18-2773-5-2-1, Nr. Brendshëm 616 18 56 521 dhe mbështet njoftimin për anulim të aktivitetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## **A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 25.12.2017 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: *“Ndërtimi i rrugëve Evlija Çelebi, Luan Qelaj dhe Halil Alidemaj”*, me Nr. **616-18-2773-5-2-1** Nr. Brendshëm **616 18 56 521**.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 15.05.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Jane pranuar 2 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 04.06.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për anulim të kontratës pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje. Me datë 04.06.2018 dhe 05.06.2018, Operatorit Ekonomik N.N.SH. *“CO-ING”*, iu ka lejuar qasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik N.N.SH. *“CO-ING”*, me date 05.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit *“Ndërtimi i rrugëve Evlija Çelebi, Luan Qelaj dhe Halil Alidemaj”*, me Nr. **616-18-2773-5-2-1** Nr. Brendshëm **616 18 56 521**, kundër Njoftimit për anulimit të aktivitetit të prokurimit të AK -së, të datës 04.06.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 05.06.2018 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

a) *Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 61 (Tenderët jo-normalisht të ulët) të Ligjit për Prokurimin Publik*

b) *Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 3 (informata të përgjithshme dhe nenin 4 (procedura e shqyrtimit - Inter Partes) të Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët.*



## **I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.**

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 6 (Parimi i Efikasitetit dhe Ekonomizimit) dhe nenin 7 (Parimi i Barazisë / jo diskriminimit) të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr. 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues hedhe poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se KK Prishtina ka vlerësuar ofertat në përputhje me LPP-ne.

### **Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 61 (Tenderët jo-normalisht të ulët) të Ligjit për Prokurimin Publik**

Ne përputhje me nenin 61.1 të LPP-se “**Tenderët Jo-Normalisht të Ulët**” - Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni. - **KK Prishtina ka kërkuar sqarim nga OE me date 24.05.2018 dhe OE ka dresuar sqarimin me date 26.05.2018.**

Ne përputhje me nenin 61.4 të LPP-se - Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin. - **KK Prishtina ka refuzuar tenderin.**

**Komisioni i vlerësimit** - Operatori Ekonomik CO-ING, nga aspekti teknik ka qenë i përgjegjshëm. Por në vlerësimin e ofertës financiare-paramasës, disa nga pozicionet janë jo-normalisht të ulëta. Ne kemi kërkuar sqarim profesional për këto pozicione për çmime njësi.

Në sqarimin e parë Operatori Ekonomik ka dhënë sqarim se këto pozicione i konverton në pozicione tjera, D.m.th nuk ka dhënë sqarim adekuat profesional për pozicionet e kërkuara, duke u bazuar në çmimet blerëse dhe vendosjen e tyre në vepër.

Po për të njëjtat pozicione kemi ri-kërkuar sqarim, për çmime njësi. Operatori Ekonomik ka dërguar disa kontrata të furnizimit me Operator tjerë , për materiale,

ku çmimet blerëse janë shumë –shumë më të mëdha se ato të paraqitura në ofertë-paramasë.
Po japim si shembull vetëm disa pozicione:
1) Poz. Zhavorr 0-63mm çmime i ofruar nga Operatori 2.95€/m3 kurse çmimi blerës i prezantuar po nga Operatori 7.5€/m3
2) Poz. Zhavorr 0-31mm çmime i ofruar nga Operatori 2.95€/m3 kurse çmimi blerës i prezantuar po nga Operatori 7.6€/m3
3) Poz. I rërës çmime i ofruar nga Operatori 1€/m3 kurse çmimi blerës i prezantuar po nga Operatori 4 €/m3
4) Poz. Materiali jo koherent i ofruar nga Operatori 1€/m3 kurse çmimi blerës i prezantuar po nga Operatori 4 €/m3
5) Poz. I gypave PE SN4 D-400 i ofruar nga Operatori 1.2 €/m3 kurse çmimi blerës i prezantuar po nga Operatori 9.9 €/m3.

**Për me tepër OE ne sqarim deklarom se çmimi i dhëne është dhëne për arsye sasitë ne paramase nuk janë reale, si p.sh:**

Ne pozicionin 2.3 - arsyeja pse këtu kemi dhëne çmimin 5 euro për cope për gyp te betonit Ø1000/1000 është se ne mendojmë qe sasitë e gypave te dhëne ne paramase nuk janë reale

Ne pozicionin 2.4 - arsyeja pse këtu kemi dhëne çmimin 5 euro për cope për gyp te betonit Ø1000/1000 është se ne mendojmë qe sasitë e gypave te dhëne ne paramase nuk janë reale

Ne pozicionin 3.2 - ne ketë pozicion kemi dhëne çmimin 10 euro /cope për grillat e ujëmbledhëseve kompozit, ne ketë pozicion sasia thotë te jete 36, kurse ne pozicion 2.1 tregon qe kemi 14 puseta ujëmbledhës, dhe kjo na jep te kuptojmë qe këtu nuk mund te vendosen me shume se vetëm 14 kapak

I njëjti sqarim është përsërit ne disa pozicione

Ne përputhje me nenin 61.5 te LPP-se - Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen. - KK Prishtina ka njoftuar KRPP.

**KK Prishtina sqaron se ka respektuar ne tërësi nenin 61 te LPP-se.**



Autoriteti Kontraktues, gjithashtu, hedhe poshtë pretendimin e OE se është shkelur neni 3 (informata të përgjithshme dhe neni 4 (procedura e shqyrtimit - Inter Partes) te Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët.

Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 3 (informata të përgjithshme dhe nenin 4 (procedura e shqyrtimit - Inter Partes) te Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët.

Ne përputhje me nenin 3 te Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët -Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

**KK Prishtina sqaron se Nuk është përmbush kushti (iii) i nenit 3 dh konkludon se ka respektuar ne tërësi nenin 4 te Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët**

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe **Rregullat për tenderët jo-normalisht të ulët**, Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.*

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

